



KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



NJOFTIM PËR OPINIONIN

Grupi i punës i udhëhequr nga ekspertët e Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit do të punojë në hartëzimin e kryeqytetit. Ideja është të krijohet një propozim hartë, në të cilën do të definohen regjionet, në të cilët saktësisht do të dihet se me çfarë burimi të energjisë do të bëhet ngrohja në secilin objekt të ri, me çka do të sigurohet parashikueshmëria për qytetarët dhe investitorët - njoftoi Marko Bislimoski, kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës pas mbledhjes së mbajtur me Odën e Ndërtimtarisë pranë Lidhjes së Odave Ekonomike. Kjo iniciativë është elaboruar edhe në mbledhjen në Odën Ekonomike të Maqedonisë veri-perëndimore.

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit vazhdoi me takimet e gjëra konsultative me anëtarët e odave ndërtimore në lidhje me ndryshimet e kërkuara në Ligjin e Ndërtimit sa i përket precizimit të Miratimit të Ndërtimit **me fushën, në të cilën detyrimisht duhet të vendoset burimi i energjisë, me të cilin do të ngrohet secili objekt i ri që do të ndërtohet.**

"Të gjitha takimet tregojnë se kemi të njëjtin qëllim, e kjo do të thotë të ketë rend dhe parashikueshmëri kur bëhet fjalë për ngrohjen e objekteve. Qytetarët, kur të blejnë objekt të ri, duhet të dinë saktë se me çka do të bëhet ngrohja, por edhe vetë kompanitë energjetike në mënyrë strategjike t'i përforcojnë investimet në regjionet e parapara dhe t'i zhvillojnë rrjetet. Ajo që na gëzon, është se tregu e bën të veten dhe sot kompanitë ndërtimore garojnë për ofrimin e zgjidhjes më cilësore për shtëpi energjetikisht më efikase. Grupi i punës i udhëhequr nga KRRE-ja do t'i bashkojë odat dhe kompanitë energjetike, që bashkarisht ti hartëzojë regjionet dhe të definojmë se si do të zhvillohen rrjetet, respektivisht në cilën pjesë të qytetit si do të zgjidhet ngrohja. Sapo përfunduar me mbledhjen në Lidhjen e Odave Ekonomike të Maqedonisë dhe tani do të vazhdojmë me mbledhjen e njëjtë edhe në odën ekonomike në Maqedoninë veri-perëndimore. Një nga problemet është ndotja e ajrit, ndërsa zgjidhjen nga fushëveprimi jonë i punës e shohim në detyrimin e ngrohjes ekologjike. Avulli, por edhe gazi janë burime të energjisë, të cilët duhet të përdoren maksimalisht. Ngruhja me rrymë duhet të jetë opcioni i fundit, pasi kjo nënkupton punë të KME Manastir (REK Bitola)" deklaroi Marko Bislimoski, kryetar i Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit.

16.10.2020

